



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCË, BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 6300 Prot.

Fier me. 18 05 .2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 46, datë 18.05.2026

“Për miratimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2025 të shoqërisë “Klubi Shumësportësh Apollonia sh.a”

Në mbështetje të Nenit 54, pika 'k' e Ligjit nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore', i ndryshuar; neni 51 dhe 53 i Ligjit nr.68 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare', i ndryshuar, ;Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Udhëzimi Nr.127, Datë 19.12.2025, "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025", Vendimit nr.5, datë 26.03.2026 të Këshillit të Administrimit “Për miratimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2025 të Klubit Shumësportësh Apollonia sh.a”, si dhe shkresës së Klubit Shumësportësh Apollonia sh.a me nr.4869 prot., datë 14.04.2026, shoqëruar me relacionin e mbajtur për të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga KSHA sh.a për vitin 2025 , Kryetari i Bashkisë Fier,

Propozon:

1. Miratimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të shoqërisë “Klubi Shumësportësh Apollonia” sh.a. për vitin ushtrimor 2025, si dhe të Raportit të Auditimit Ligjor, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Humbja që rezulton sipas pasqyrave financiare të vitit 2025 të kalojë në llogarinë fitime/humbje të mbartura.
3. Ngarkohet Klubi Shumësportësh Apollonia sh.a, Fier për zbatimin e këtij vendimi.

**Drejtoria e Financës,
Buxhetit dhe Kontabilitetit/
Pranvera Çina**

**Administratori i Klubit
Shumësportësh Apollonia sh.a
Palion Zarka**

**KRYETAR
Armando Subashi**

